

PROJEKTLIGJ
“PËR SISTEMIN E PAGESAVE DHE KOLATERALIN FINANCIAR”

Përafruar me:

Direktivën 98/26/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 19 maj 1998, për finalitetin e shlyerjes në sistemet e pagesave dhe në sistemet e shlyerjes së titujve, Fletorja Zyrtare L 166, fq. 45, datë 11.6.1998,

ndryshuar me:

1. Direktivën 2009/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 6 maj 2009, Fletorja Zyrtare L 146, fq. 37, datë 10.6.2009;
2. Direktivën 2010/78/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 24 nëntor 2010, Fletorja Zyrtare L 331, fq. 120, datë 15.12.2010;
3. Rregulloren (BE) 648/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 4 korrik 2012, Fletorja Zyrtare L 201, fq.1, datë 27.7.2012;
4. Rregulloren (BE) Nr. 909/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 korrik 2014, Fletorja Zyrtare L 257, fq. 1, datë 28.8.2014;
5. Direktivën (BE) 2019/879 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 20 maj 2019, Fletorja Zyrtare L 150, fq. 296, datë 7.6.2019;
6. Rregulloren (BE) 2024/886 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 mars 2024, Fletorja Zyrtare L 886, fq. 1, datë 19.3.2024.

Direktivën 2002/47/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 6 qershor 2002, për marrëveshjet e kolateralit financiar, Fletorja Zyrtare L 168, fq. 43, datë 27.6.2002

ndryshuar me:

1. Direktivën 2009/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 6 maj 2009, Fletorja Zyrtare L 146, fq. 37, datë 10.6.2009;
2. Direktivën 2014/59/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, Fletorja Zyrtare L 173, fq. 190, datë 12.6.2014;
3. Rregulloren (BE) 2021/23 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 16 dhjetor 2020, Fletorja Zyrtare L 22, fq. 1, datë 22.1.2021.

Përmbajtja

Kreu I: Dispozita të përgjithshme

Neni 1	5
Qëllimi.....	5
Neni 2.....	5
Objekti.....	5
Neni 3.....	6
Bashkëpunimi ndërinstitucional.....	6
Neni 4.....	6
Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave.....	6
Neni 5.....	6
Përkufizime	6
Neni 6.....	11
Licencimi ose miratimi.....	11
Neni 7.....	12
Shfuqizimi ose pezullimi i licencës.....	12
Neni 8.....	12
Rregullimi dhe mbikëqyrja (“oversight”).....	12
Neni 9.....	12
Kompetenca inspektuese e Bankës së Shqipërisë	12
Neni 10.....	13
Kompetenca vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë	13
Neni 11	13
Masa ndëshkimore.....	13
Neni 12.....	13
Sanksione administrative.....	13
Neni 13.....	14
Lista e sistemeve	14
Neni 14.....	14
Rregullimi dhe mbikëqyrja (“oversight”) e shërbimeve dhe e instrumenteve të pagesave	14
Neni 15.....	14
Fusha e zbatimit	14

Neni 16.....	15
Pjesëmarrësit në sisteme.....	15
Neni 17.....	15
Sistemet e njohura (“ <i>designated</i> ”) me finalitet shlyerje	15
Neni 18.....	16
Parimi i finalitetit, urdhër-transferta dhe netimi.....	16
Neni 19.....	17
Parevokueshmëria e urdhër-transfertës	17
Neni 20.....	17
Çasti i hapjes së procedurës për paaftësi paguese dhe njoftimet përkatëse	17
Neni 21	18
Efekti jo prapaveprues i procedurës për paaftësi paguese mbi pjesëmarrjen në sistem... 18	
Neni 22.....	18
Efektet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme	18
Neni 23.....	19
Mbrotjtja e të drejtave të kolateralit në sistemet e pagesave dhe operacionet e bankave qendrore.....	19
Neni 24.....	20
Mbrotjtja e llogarisë së shlyerjes.....	20
Neni 25.....	20
Njoftimet e sistemeve të njohura (“ <i>designated</i> ”) si sisteme me finalitet shlyerje	20
Neni 26.....	20
Ligji i zbatueshëm	20
Neni 27.....	21
Sistemet e Bankës së Shqipërisë	21
Neni 28.....	21
Rregullat e operimit të sistemeve të Bankës së Shqipërisë	21
Neni 29.....	21
Masa administrative	21
Neni 30.....	22
Fusha e zbatimit	22
Neni 31	23
Kolaterali financiar i përjashtuar nga fusha e zbatimit	23

Neni 32	24
Vlefshmëria dhe njohja e marrëveshjes së kolateralit financiar	24
Neni 33	25
Ekzekutimi i marrëveshjes së kolateralit financiar	25
Neni 34	26
E drejta e përdorimit të kolateralit financiar në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu	26
Neni 35	27
Njohja e marrëveshjes së kolateralit financiar me transferim të titullit të pronësisë	27
Neni 36	27
Kolaterali financiar zëvendësues dhe kolaterali financiar shtesë	27
Neni 37	27
Vlefshmëria dhe njohja e dispozitës së netimit përfundimtar	27
Neni 38	28
Efekti joprapaveprues mbi kolateralin financiar në rastet e paaftësisë pagueuse	28
Neni 39	28
Radha e preferencës së të drejtave mbi pengun	28
Neni 40	29
Marrëdhënia me legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme	29
Neni 41	29
Ligji i zbatueshëm për titujt e dematerializuar	29
Neni 42	29
Pranueshmëria e provës elektronike dhe optike	29
Neni 43	30
Procedura “ <i>truncation</i> ”	30
Neni 44	30
Shfuqizime	30
Neni 45	30
Zbatimi i akteve nënligjore ekzistuese	30
Neni 46	30
Hyrja në fuqi	30



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2026

“PËR SISTEMIN E PAGESAVE DHE KOLATERALIN FINANCIAR”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ligji synon të nxisë sigurinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri, si dhe të garantojë vlefshmërinë, efektivitetin dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjeve të kolateralit financiar.

Neni 2
Objekti

1. Ligji përcakton parimet bazë që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mbikëqyrjen (“oversight”) e sistemit të pagesave në baza të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase.
2. Në funksion të arritjes së qëllimit të ligjit, Banka e Shqipërisë, ushtron tre role kryesore:
 - a) rolin e mbikëqyrësit, nëpërmjet licencimit ose miratimit, rregullimit dhe mbikëqyrjes së elementeve të rëndësishëm të sistemit kombëtar të pagesave;

- b) rolin e katalizatorit, nëpërmjet nxitjes dhe koordinimit të reformave rregullatore dhe zhvillimeve në fushën e pagesave, si dhe krijimit të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, sipas nenit 4 të ligjit;
 - c) rolin e operatorit të sistemeve të pagesave që operohen prej saj, nëpërmjet administrimit dhe operimit të sistemeve të pagesave, përcaktimit të rregullave të pjesëmarrjes, si dhe masave administrative.
3. Dispozitat e Kreut III rregullojnë mbrojtjen e sistemeve ndaj paaftësisë paguese, përfshirë finalitetin e shlyerjes me qëllim reduktimin e rrezikut sistematik që lidhet me pjesëmarrjen në sistemet e pagesave, shtëpitë e klerimit, sistemet e shlyerjes së titujve, kundërpartitë qendrore dhe depozitarët qendrore.
 4. Dispozitat e Kreut V të këtij ligji rregullojnë të gjitha rastet e marrëveshjeve të kolateralit financiar.

Neni 3

Bashkëpunimi ndërinstytucional

Banka e Shqipërisë, në përmbushjen e detyrave të saj të përcaktuara në këtë ligj, bashkëpunon me cilindo autoritet vendas dhe të huaj, me qëllim shkëmbimin e informacionit, bashkërendimin e veprimtarive, apo realizimin e marrëveshje të tjera të bashkëpunimit, nëse gjykohet e nevojshme.

Neni 4

Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave

1. Banka e Shqipërisë krijon një komitet kombëtar për sistemin e pagesave, i cili nëpërmjet veprimtarisë së tij, mbështet dhe kontribuon për rritjen e sigurisë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e sistemit të pagesave në përmbushje të objektivit ligjor të Bankës së Shqipërisë për të nxitur funksionimin normal të tij.
2. Banka e Shqipërisë me akt nënligjor përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e komitetit kombëtar për sistemin e pagesave.

Neni 5

Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Sistemi” është një marrëveshje formale ndërmjet tre ose më shumë pjesëmarrësve, me rregulla të përbashkëta dhe procedura të standardizuara për klerimin, netimin dhe shlyerjen e urdhër-transfertave, i njohur (“*designated*”) sipas nenit 17 të këtij ligji.

2. "Sisteme ndërvepruese" nënkupton dy ose më shumë sisteme, operatorët e sistemit të të cilave kanë hyrë në një marrëveshje me njëri-tjetrin që përfshin ekzekutimin e urdhër-transfertave ndërmjet sistemeve;
3. "Shtëpi klerimi" është personi juridik që bën llogaritjen dhe krijimin e pozicioneve neto të një institucioni, një kundërparti qendrore dhe/ose agjentë shlyerës;
4. "Kundërparti qendrore" (CCP) ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit "Për tregjet e kapitalit", i cili transponon rregulloren (BE) Nr. 648/2012 deri në anëtarësim e Shqipërisë, dhe pas anëtarësimit sipas nenit 2, pika 1 të rregullores (BE) Nr. 648/2012;
5. "Agjent shlyerës" është personi juridik që u ofron llogari shlyerje, institucioneve dhe/ose një kundërparti qendrore, pjesëmarrëse në sisteme, nëpërmjet të cilave shlyhen urdhër-transfertat në sisteme, dhe sipas rastit mund t'u ofrojë atyre kredi për qëllime shlyerjeje;
6. "Pjesëmarrës" është një institucion, një kundërparti qendrore, një agjent shlyerës, një shtëpi klerimi, një operator sistemi ose një anëtar klerimi i një kundërparti qendrore i licencuar në përputhje me legjislacionin për tregjet e kapitalit;
7. "Nënpjesëmarrës" është një institucion financiar, një kundërparti qendrore, një agjent shlyerës, një shtëpi klerimi ose një operator sistemi, i cili ka marrëdhënie kontraktore me një pjesëmarrës në një sistem që ekzekuton urdhër-transfertat, duke mundësuar nënpjesëmarrësin të transferojë urdhrat nëpërmjet sistemit. Nënpjesëmarrësi konsiderohet i tillë vetëm nëse është i identifikuar dhe i njohur nga operatori i sistemit në përputhje me rregullat e sistemit;
8. "Urdhër-transferta" është:
 - a) një udhëzim nga një pjesëmarrës për të vënë në dispozicion të një përfituesi një shumë parash, me anë të regjistrimit në llogari apo transferimit elektronik në llogarinë pranë një banke, një banke qendrore ose një agjenti shlyerës, ose çdo udhëzim që përcakton marrjen përsipër ose kryerjen e një detyrimi për të paguar sipas rregullave të sistemit; ose
 - b) një udhëzim nga një pjesëmarrës për të transferuar titullin e pronësisë, ose të drejta të tjera mbi instrumentin financiar, nëpërmjet regjistrimit në llogaritë e një regjistri ose në ndonjë mënyre tjetër;
9. "Llogari shlyerje" është një llogari pranë Bankës së Shqipërisë, pranë një agjenti shlyerës ose pranë një kundërpartie qendrore, e përdorur për të mbajtur *cash*-in ose tituj dhe që shërben për të shlyer transaksionet ndërmjet pjesëmarrësve në një sistem;
10. "Tituj" janë instrumentet financiare sipas përcaktimeve të legjislacionit për tregjet e kapitalit;
11. "Institucion" është:
 - a) një institucion krediti sipas përcaktimeve të legjislacionit për institucionet e kreditit në Republikën e Shqipërisë;
 - b) një subjekt që kryen veprimtari bankare ose financiare, ushtrimi i veprimtarisë të të cilit bëhet me ligj të veçantë, i ndryshëm nga legjislacioni për institucionet e kreditit.
 - c) Banka e Shqipërisë dhe banka qendrore të huaja;

- d) shoqëri komisionere, veprimtaria e së cilës rregullohet sipas legjislacionit për tregjet e kapitalit;
 - e) autoritetet publike dhe subjekte, detyrimet e të cilëve janë të garantuara me fonde publike; ose
 - f) institucione krediti ose shoqëri komisionere të huaja, të rregulluara në mënyrë të ngjashme me institucionet në shkronjat “a” dhe “d”,
të cilët marrin pjesë në një sistem pagesash dhe janë përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga urdhrat e transfertave brenda këtij sistemi;
 - g) një institucion pagesash i rregulluar sipas ligjit “Për shërbimet e pagesave”, me përjashtim të personit fizik ose juridik që përfiton nga përjashtimet sipas nenit 27 ose 28 të atij ligji; ose
 - h) një institucion i parasë elektronike i rregulluar sipas ligjit “Për shërbimet e pagesave”, me përjashtim të personit juridik që përfiton nga përjashtimet sipas nenit 28/8 të atij ligji,
i cili merr pjesë në një sistem, veprimtaria e të cilit konsiston në ekzekutimin e urdhër-transfertave sipas përcaktimeve të pikës 8, shkronja “a” të këtij neni, dhe të cilët janë përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga këto urdhra-transfertash brenda këtij sistemi. Për qëllime të këtij ligji, institucion mund të konsiderohet nga Banka e Shqipërisë, edhe një subjekt që merr pjesë në një sistem të rregulluar nga ky ligj dhe që ekzekuton vetëm urdhra-transferte sipas përcaktimeve të pikës 8, shkronja “b” e këtij neni, si dhe ekzekuton pagesat që rezultojnë nga këto urdhra, i cili ka përgjegjësi për shlyerjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga urdhrat e transfertave brenda këtij sistemi, me kusht që të paktën tre pjesëmarrës të këtij sistemi të përfshihen në kategoritë e mësipërme dhe që një vendim i tillë të jetë i garantuar për shkak të rrezikut sistematik
12. “Operator i sistemit” është personi juridik që, i vetëm ose në bashkëpunim me persona të tjerë juridikë, është përgjegjës për të operuar një sistem. Një operator sistemi mund të veprojë gjithashtu si agjent shlyerjeje, kundërparti qendrore ose shtëpi klerimi;
13. “Procedura për paaftësi paguese” është çdo procedurë falimentimi, likuidimi, riorganizimi, e përcaktuar në ligjet e Republikës së Shqipërisë apo të ndonjë vendi tjetër, e cila kryhet me ndërhyrjen e autoriteteve administrative ose gjyqësore, dhe që ka si pasojë, ndër të tjera, pezullimin e, ose vendosjen e kufizimeve mbi, transfertat apo pagesat, pezullimin e masave të ekzekutimit ose zhvlerësimin e pretendimeve.
Për efekt të këtij ligji, masat e ndërhyrjes ndërhyrjes se hershme, te rimëkëmbjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme trajtohen në përputhje me legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka dhe nuk konsiderohen, vetëm për shkak të marrjes së tyre, si procedura për paaftësi paguese, për sa kohë vijon përmbushja e detyrimeve thelbësore përkatëse.
14. “Instrument pagese” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit për shërbimet e pagesave;
15. “Shërbimet e pagesave” ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit për shërbimet e pagesave;

16. "Ditë pune" mbulon shlyerjet si gjatë ditës ashtu edhe gjatë natës dhe përfshin të gjitha ngjarjet që ndodhin gjatë ciklit të biznesit të një sistemi;
17. "Kolateral" ("*collateral security*") është çdo aktiv i realizueshëm, përfshirë, pa kufizim, kolateralin financiar sipas përcaktimeve të këtij ligji, i dhënë në formë pengu, përfshirë paratë (*cash*) e dhëna në formë pengu, një marrëveshjeje riblerjeje ose marrëveshjeje të ngjashme, apo në formë tjetër, me qëllim garantimin e të drejtave dhe detyrimeve që mund të lindin në lidhje me pjesëmarrjen në një sistem ose që jepet në favor të bankave qendrore ose Bankës Qendrore Evropiane;
18. "*Cash*" janë paratë e kredituara në një llogari në çfarëdolloj valute ose pretendime të ngjashme monetare të ripagueshme, të tilla si depozitat monetare;
19. "Dhënës kolaterali" është personi juridik që ofron kolateral financiar nëpërmjet një marrëveshjeje për transferimin e pronësisë së titullit, ose një pengdhënës;
20. "Marrës kolaterali" është personi juridik që përfiton kolateralin financiar nëpërmjet një marrëveshjeje për transferimin e pronësisë së titullit, ose një pengmarrës;
21. "E drejtë përdorimi" është e drejta e marrësit të kolateralit, kur kjo parashikohet në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu, për të përdorur, shitur, transferuar, dhënë si kolateral, riinvestuar, zëvendësuar ose ushtruar çdo të drejtë tjetër ekonomike ose juridike mbi kolateralin financiar, në përputhje me kushtet e marrëveshjes së kolateralit financiar me vendosje pengu;
22. "Kompensim" ("*set-off*") është shuarja e plotë ose e pjesshme e një detyrimi financiar nëpërmjet përllogaritjes së tij kundrejt një pretendimi financiar përkatës që ekziston ndërmjet palëve;
23. "Netim" ("*netting*") është llogaritja dhe konvertimi i pretendimeve dhe detyrimeve të ndërsjellta ndërmjet palëve në një shumë të vetme neto të pagueshme nga njëra palë tek tjetra;
24. "Dispozita e netimit përfundimtar" ("*close-out netting provision*") është dispozita e një marrëveshjeje kolaterali financiar, ose e një marrëveshjeje tjetër, pjesë e së cilës është një marrëveshje kolaterali financiar, ose, në mungesë të këtyre marrëveshjeve, çdo rregull juridik, sipas së cilës, në rast të ndodhjes së një situatë ekzekutimi, qoftë përmes netimit ose kompensimit apo në ndonjë mënyrë tjetër:
 - a) detyrimet e palëve bëhen menjëherë të kërkueshme, ose ndërpriten dhe zëvendësohen me detyrime për pagimin e vlerës së tyre të përllogaritur;
 - b) kryhet llogaritja e pretendimeve dhe detyrimeve reciproke midis palëve;
 - c) përcaktohet një shumë përfundimtare neto, nëpërmjet netimit të pretendimeve dhe detyrimeve të palëve.
25. "Marrëveshje kolaterali financiar" është një marrëveshje me transferim të titullit të pronësisë ose një marrëveshje me vendosje pengu, e rregulluar ose jo nga një marrëveshje kuadër ose nga një marrëveshje tjetër që përmban kushte të përgjithshme kontraktore, dhe që ka si objekt kolateralin financiar për të garantuar përmbushjen e një detyrimi financiar;

26. “Marrëveshje kolaterali financiar me transferim të titullit të pronësisë” është një marrëveshje, përfshirë marrëveshjen repo, sipas së cilës dhënësi i kolateralit transferon pronësinë e plotë, ose të drejta të plota, mbi kolateralin financiar tek marrësi i kolateralit, për të garantuar ose mbuluar përmbushjen e detyrimeve financiare përkatëse;
27. “Marrëveshje kolaterali financiar me vendosje pengu” është një marrëveshje sipas së cilës dhënësi i kolateralit i jep kolateral financiar marrësit të kolateralit për të garantuar përmbushjen e një detyrimi financiar, dhe pronësia e plotë ose me të drejta kontrolluese, ose të drejtat e plota, mbi kolateralin financiar mbeten tek dhënësi i kolateralit edhe pas vendosjes së tij si peng;
28. “Instrumente financiare” janë:
- a) aksionet vendase ose të huaja dhe tituj të tjerë të ngjashëm me aksionet;
 - b) obligacionet dhe format e tjera të instrumenteve të borxhit, nëse këto janë të negociueshme në tregun e kapitalit;
 - c) çdo produkt tjetër financiar i tregtueshëm në tregun e kapitalit dhe që jep të drejtën për të fituar aksione, obligacione ose tituj të tjerë financiarë me anë të nënshkrimit, blerjes ose shkëmbimit ose që krijon të drejtën për shlyerje në para, me përjashtim të instrumenteve të pagesës;
 - d) kuotat në sipërmarrjet e investimeve kolektive;
 - e) instrumentet e tregut të parasë;
 - f) metalet e çmuara të kredituara në një llogari; dhe
 - g) pretendimet ose të drejtat që rrjedhin nga instrumentet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “f” të kësaj pike.
29. “Detyrime financiare përkatëse” janë detyrimet që sigurohen nga një marrëveshje kolaterali financiar dhe që japin të drejtën për shlyerje në para dhe/ose dorëzim të instrumentit financiar ose të drejtë për të marrë ose përvetësuar pretendime kreditore. Këto mund të përbëhen nga ose të përfshijnë:
- a) detyrime aktuale ose të ardhshme, të kushtëzuara ose të mundshme, përfshirë detyrimet që lindin nga një marrëveshje kuadër ose nga një marrëveshje e ngjashme;
 - b) detyrime që një person, i ndryshëm nga dhënësi i kolateralit, i detyrohet marrësit të kolateralit; ose
 - c) detyrime që lindin herë pas here, të një tipologjie ose lloji të caktuar, të parashikuara në një marrëveshje ndërmjet palëve.
30. “Kolateral ekuivalent” nënkupton:
- a) në lidhje me *cash*-in, pagesën e të njëjtës shumë dhe në të njëjtën monedhë;
 - b) në lidhje me instrumentet financiare, instrumente financiare të të njëjtit emetues ose debitor, që bëjnë pjesë në të njëjtin emetim ose klasë dhe që kanë të njëjtën vlerë nominale, monedhë dhe karakteristika ose, aktive të tjera kur marrëveshja e kolateralit financiar parashikon transferimin e aktiveve të tjera pas ndodhjes së çdo ngjarjeje që lidhet me ose ndikon instrumentet financiare të dhëna si kolateral financiar.

31. “Pretendime kreditore” (“*credit claims*”) janë pretendimet që rrjedhin nga një marrëveshje sipas së cilës një institucion krediti, përfshirë institucione që kryejnë veprimtari bankare e financiare, ushtrimi i veprimtarisë të të cilave bëhet me ligj të veçantë, i ndryshëm nga legjislacioni për institucionet e kreditit, jep kredi
32. “Situatë ekzekutimi” (“*enforcement event*”) është ngjarja e mos përmbushjes së detyrimit ose çdo situatë tjetër e ngjashme e rënë dakord ndërmjet palëve, me ndodhjen e së cilës, sipas kushteve të marrëveshjes së kolateralit financiar ose në bazë të ligjit, marrësi i kolateralit ka të drejtë të realizoj ose përvetësoj kolateralin financiar ose të zbatojë dispozitën e netimit përfundimtar;
33. “Llogaria përkatëse” është regjistri apo llogaria, ku regjistrohet kolaterali në formën e titujve të dematerializuar, subjekt i një marrëveshjeje kolateralit financiar, duke iu vënë në dispozicion marrësit të kolateralit. Ky regjistër apo llogari mund të mbahet edhe nga marrësi i kolateralit.
34. “Banka e Shqipërisë” është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë, e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe që funksionon sipas Ligjit për Bankën e Shqipërisë;
35. “*Truncation*” është zëvendësimi i një çeku, kambiali, ose letre premtimi origjinal, me një instrument tjetër, ose me një marrëveshje, që ka informacionin e instrumentit fillestar, me ose pa dorëzimin e instrumentit origjinal.

KREU II RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E SISTEMEVE

Neni 6 **Licencimi ose miratimi**

1. Sistemet në Shqipëri operohen vetëm nga persona juridikë të licencuar ose të miratuar nga Banka e Shqipërisë.
2. Në rastin e kërkesës për operim sistemi pagese nga persona juridikë, të cilët janë licencuar sipas legjislacionit bankar/për institucionet e kreditit, dhe/ose legjislacionit për shërbimet e pagesave, Banka e Shqipërisë jep vetëm miratim.
3. Në rastin e licencimit të sistemit të shlyerjes së titujve, të shtëpisë së klerimit të titujve, depozitarit qendror të titujve, dhe të kundërpartisë qendrore, Banka e Shqipërisë bashkëpunon me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për licencimin e këtyre subjekteve. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me marrëveshje dypalëshe, përcaktojnë rolin e secilit institucion në licencimin e sistemit të shlyerjes së titujve, shtëpisë të klerimit të titujve, depozitarit qendror të titujve dhe të kundërpartisë qendrore.
4. Banka e Shqipërisë me akt nënligjor përcakton kriteret dhe procedurat e nevojshme për licencimin dhe miratimin e sistemeve që operojnë në Shqipëri.

Neni 7

Shfuqizimi ose pezullimi i licencës

1. Banka e Shqipërisë mund të shfuqizojë ose pezullojë licencën apo miratimin e një sistemi nëse në opinionin e saj:
 - a) operatori nuk ka filluar aktivitetin brenda 12 muajve nga data në të cilën është dhënë licenca ose miratimi;
 - b) operatori ka pushuar së ushtruari veprimtarinë e tij për një periudhë më të gjatë se 1 muaj;
 - c) operatori ka marrë licencë ose miratimin për sistemin përmes deklaratave të rreme apo rrugëve të tjera të parregullta;
 - d) operatori i sistemit nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret e aplikueshme për licencimin ose miratimin;
 - e) operatori përfshihet në procedurë për paaftësi paguese;
 - f) sistemi kërcënon stabilitetin e sistemit financiar në Shqipëri;
 - g) sistemi nuk është më në interes të publikut ose në interes të pjesëmarrësve.
2. Menjëherë pas marrjes së vendimit, për të shfuqizuar ose pezulluar, licencën ose miratimin, Banka e Shqipërisë njofton operatorin përkatës dhe publikon njoftimin.

Neni 8

Rregullimi dhe mbikëqyrja (“oversight”)

1. Banka e Shqipërisë rregullon dhe mbikëqyr (“oversight”) sistemet e licencuara duke miratuar akte nënligjore për këtë qëllim.
2. Banka e Shqipërisë mund të vendosë standarde dhe kërkesa të tjera shtesë mbi operatorët, sistemet, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit.
3. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me marrëveshje dypalëshe, përcaktojnë rolin e secilit institucion, në lidhje me rregullimin dhe mbikëqyrjen (“oversight”) e sistemit të shlyerjes së titujve, shtëpisë së klerimit të titujve, depozitarit qendror të titujve dhe të kundërpartisë qendrore.

Neni 9

Kompetenca inspektuese e Bankës së Shqipërisë

1. Me qëllim që të sigurohet dhe të kontrollohet zbatimi i këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, punonjës të Bankës së Shqipërisë, si dhe persona të tjerë të kualifikuar, të emëruar prej saj, mund të vizitojnë zyrat e sistemeve, operatorët, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit, për të kontrolluar llogaritë, regjistrat, dokumentet dhe shkresa të tjera, për të marrë informacion dhe të dhëna prej tyre, si dhe të ndërmarrin veprime të tjera që Banka e Shqipërisë mund të vlerësojë si të nevojshme ose të dobishme.

2. Operatorët, pjesëmarrësit dhe nënpjesëmarrësit vënë në dispozicion të Bankës së Shqipërisë llogaritë, regjistrat, dokumente dhe të shkresa të tjera të kërkuara nga ligji dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ose çdo lloj informacioni dhe të dhëne shtesë, të cilat Banka e Shqipërisë i vlerëson të nevojshme apo të dobishme.

Neni 10

Kompetenca vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë

Në përputhje me Ligjin për Bankën e Shqipërisë, me ligjet e tjera të fushës dhe aktet e tjera nënligjore, Banka e Shqipërisë mund të nxjerrë urdhra, udhëzime dhe vendime, nëpërmjet të cilave t'u kërkojë sistemeve, operatorëve, pjesëmarrësve dhe nënpjesëmarrësve për të vepruar, ose për të mos vepruar, në çfarëdolloj mënyre që, Banka e Shqipërisë e vlerëson të nevojshme ose të këshillueshme.

Neni 11

Masa ndëshkimore

1. Banka e Shqipërisë, në rast shkeljeje të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij nga operatorët, pjesëmarrësit apo nënpjesëmarrësit, merr masa mbikëqyrëse, masa parandaluese, si dhe urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe ndreqjen e pasojave që kanë rrjedhur prej tyre.
2. Banka e Shqipërisë me akt nënligjor përcakton kushtet e hollësishme dhe metodat për marrjen e masave të përcaktuara në pikën 1.

Neni 12

Sanksione administrative

1. Krahas masave ndëshkimore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, në rast të shkeljeve të dispozitave të këtij ligji, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë gjoba kundrejt operatorëve.
2. Banka e Shqipërisë gjosit operatorin me 500 000 (pesëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milionë) Lekë kur konstaton se ai:
 - a) vepron në kundërshtim me nenin 6, pika 1;
 - b) vepron në kundërshtim me nenin 9, pika 2;
 - c) pengon Bankën e Shqipërisë të kryejë inspektimet sipas nenit 9, pika 1;
 - d) nuk zbaton masat ndëshkimore të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë sipas nenit 11;
 - e) vepron në kundërshtim me nenin 14;
 - f) shkel detyrime të tjera të vendosura me këtë ligj.
3. Kur shkeljet e përcaktuara në shkronjat "b" deri në "f" të pikës 2, përsëriten ose gjoba nuk paguhet brenda afatit dhe, sipas procedurës të përcaktuar në ligjin "Për

kundërvajtjet administrative“, Banka e Shqipërisë vendos dyfishimin e gjobës dhe mund të:

- a) pezullojë licencën e sistemit deri në 6 muaj;
 - b) revokojë licencën e sistemit.
4. Gjobat e vendosura sipas këtij neni, arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë.
 5. Çdo operator, që cënohet nga një akt administrativ i Bankës së Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e këtij akti nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë brenda 15 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose nga data e publikimit të tij.

Neni 13 **Lista e sistemeve**

1. Banka e Shqipërisë publikon dhe administron listën e sistemeve dhe operatorëve të licencuar ose miratuar, që mbikëqyren (“*oversight*”) prej saj.
2. Lista e sistemeve përditësohet pas çdo ndryshimi që ndodh sipas nenit 6, pika 2 dhe 3 dhe nenit 7 të ligjit.

Neni 14 **Rregullimi dhe mbikëqyrja (“*oversight*”) e shërbimeve dhe e instrumenteve të pagesave**

1. Banka e Shqipërisë mund të rregullojë dhe të mbikëqyrë (*oversight*) përdorimin e instrumenteve të pagesave dhe ofrimin e shërbimeve të pagesave si pjesë e sistemit kombëtar të pagesave, me qëllim që të garantojë sigurinë, mirëfunksionimin dhe efikasitetin e tyre.
2. Dispozitat e ligjit zbatohen edhe për aspekte të rregullimit dhe mbikëqyrjes (*oversight*) së instrumenteve të pagesave, aty ku është e përshtatshme.

KREU III MBROJTJA E SISTEMEVE

Neni 15 **Fusha e zbatimit**

Dispozitat e këtij kreu zbatohen për:

- a) çdo sistem të përcaktuar sipas nenit 5, pika 1 dhe nenit 17 të ligjit, dhe që operon në çdo monedhë, në Lekë, Euro, ose në disa monedha që sistemi i konverton kundrejt njëra-tjetrës, dhe që rregullohet nga legjislacioni shqiptar ose, kur është e zbatueshme, nga legjislacioni i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian pas anësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

- b) çdo pjesëmarrës në një sistem të tillë;
- c) çdo kolateral të ofruar në lidhje me:
 - i. pjesëmarrjen në një sistem; ose
 - ii. operacionet e Bankës së Shqipërisë, dhe pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë, operacionet e bankave qendrore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, përfshirë Bankën Qendrore Evropiane në ushtrimin e funksioneve të tyre si banka qendrore.

Neni 16

Pjesëmarrësit në sisteme

1. Në përputhje me rregullat e sistemit, pjesëmarrësi sipas përkufizimit të nenit 5, pika 6, të këtij ligji, mund të veprojë edhe si kundërparti qendrore, si agjent shlyerës ose si shtëpi klerimi, ose të kryejë një pjesë ose të gjitha këto detyra.
2. Banka e Shqipërisë për qëllimet e këtij ligji, mund të konsiderojë një nënpjesëmarrës si pjesëmarrës kur kjo është e justifikueshme në bazë të rrezikut sistemik. Megjithatë, në këtë rast, nuk do të kufizohet përgjegjësia e pjesëmarrësit përmes të cilit nënpjesëmarrësi kalon urdhër-transferta në sistem.

Neni 17

Sistemet e njohura (“*designated*”) me finalitet shlyerje

1. Sistem është një marrëveshje formale:
 - a) ndërmjet tre ose më shumë pjesëmarrësve, përjashtuar operatorin e vetë sistemit, agjentin shlyerës, kundërpartinë qendrore, shtëpinë e klerimit ose nënpjesëmarrësin, me rregulla të përbashkëta dhe marrëveshje të standardizuara për klerimin, nëpërmjet kundërpartisë qendrore ose pa atë, ose ekzekutimin e urdhër-transferta ndërmjet pjesëmarrësve;
 - b) të rregulluar nga legjislacioni shqiptar ose, kur është e zbatueshme, nga legjislacioni i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, i zgjedhur nga pjesëmarrësit, me kusht që të paktën njëri prej pjesëmarrësve të ketë selinë qendrore në atë shtet;
 - c) i njohur (“*designated*”) si i tillë nga Banka e Shqipërisë dhe/ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të njoftuar pranë Autoritetit Evropian të Titujve dhe Tregjeve (ESMA).. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, njofton Komisionin Evropian dhe Autoritetin Evropian për Titujt dhe Tregjet (ESMA) për sistemet e njohura (“*designated*”), në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.
2. Në zbatim të pikës 1, Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për njohjen (“*designation*”) e sistemeve të pagesave. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në

bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për njohjen (“*designation*”) e sistemeve të shlyerjes së titujve, depozitarëve qendrorë të titujve, kundërpalëve qendrore dhe shtëpive të klerimit të titujve. Kur infrastruktura ushtron funksione që bien brenda kompetencës së të dy autoriteteve, njohja (“*designation*”) kryhet në bazë të një procedure të përbashkët të përcaktuar me marrëveshje.

3. Një sistem konsiderohet si i njohur (“*designated*”) vetëm pasi Banka e Shqipërisë dhe/ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare verifikon që sistemi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
4. Banka e Shqipërisë dhe/ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mund të njohë (“*designate*”) si sistem edhe një marrëveshje formale që ekzekuton urdhër-transferta, sipas përkufizimit në nenin 5, pika 28, shkronja “b” e këtij ligji, dhe, në masë të kufizuar, urdhra që lidhen me instrumente të tjera financiare, kur një përcaktim i tillë justifikohet nga rreziku sistemik.
5. Banka e Shqipërisë dhe/ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare mund të njohë (“*designate*”) si sistem, rast pas rasti, një marrëveshje formale ndërmjet dy pjesëmarrësve, kur kjo konsiderohet e justifikuar për shkak të rrezikut sistemik.
6. Marrëveshja për lidhjen ndërmjet sistemeve ndërvepruese nuk përbën në vetvete sistem.

Neni 18

Parimi i finalitetit, urdhër-transferta dhe netimi

1. Urdhër-transfertat dhe netimi janë të vlefshme, ligjërisht të ekzekutueshme dhe të detyrueshme ndaj palëve të treta, edhe në rast të hapjes së procedurës për paaftësi paguese ndaj një pjesëmarrësi, me kusht që urdhër-transfertat të kenë hyrë në sistem përpara çastit të hapjes së kësaj procedure sipas nenit 20, pika 1 e këtij ligji.
2. Çasti i hyrjes së urdhër-transfertës në sistem përcaktohet në mënyrë të qartë nga rregullat e sistemit.
3. Në rastin e sistemeve ndërvepruese, secili sistem përcakton në rregullat e veta çastin e hyrjes së urdhër-transfertës në sistem, duke u siguruar për atë sa është e mundur që këto rregulla janë të koordinuara. Rregullat e një sistemi për çastin e hyrjes së urdhër-transfertës nuk preken nga rregullat e sistemeve të tjera me të cilat ai është ndërveprues me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga rregullat e të gjitha sistemeve ndërvepruese të përfshira.
4. Parashikimi i pikës 1 zbatohet edhe kur procedura për paaftësi paguese hapet ndaj një pjesëmarrësi (në sistemin përkatës ose në një sistem ndërveprues) ose ndaj operatorit të sistemit të një sistemi ndërveprues që nuk është pjesëmarrës.
5. Urdhër-transfertat, që hyjnë në sistem pas çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese dhe që ekzekutohen gjatë ditës së punës në të cilën është hapur kjo procedurë, janë të vlefshme, ligjërisht të ekzekutueshme dhe të detyrueshme ndaj palëve të treta vetëm nëse operatori i sistemit provon se, në çastin kur këto urdhër-transferta u bënë të

parevokueshme, ai nuk kishte dijeni dhe as nuk duhej të kishte dijeni për hapjen e procedurës.

6. Asnjë ligj, akt nënligjor, rregull, praktikë apo dispozitë tjetër që rregullon pavlefshmërinë, anulimin ose kundërshtimin e kontratave dhe veprimeve juridike, të kryera përpara çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese, nuk sjell prishjen e netimit.

Neni 19

Parevokueshmëria e urdhër-transfertës

1. Urdhër-transferta e futur në sistem, duke filluar nga çasti i përcaktuar si çasti i parevokueshmërisë nga rregullat e këtij sistemi, nuk mund të revokohet nga një pjesëmarrës i sistemit, apo nga cilado palë e tretë.
2. Në rastin e sistemeve ndërvepruese, secili sistem përcakton në rregullat e veta çastin e parevokueshmërisë së urdhër-transfertës në sistem, duke siguruar, për aq sa është e mundur, koordinimin e këtyre rregullave ndërmjet sistemeve ndërvepruese. Rregullat e një sistemi për çastin e parevokueshmërisë së urdhër-transfertës nuk preken nga rregullat e sistemeve të tjera me të cilat ai është ndërveprues, me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga rregullat e të gjitha sistemeve ndërvepruese të përfshira.

Neni 20

Çasti i hapjes së procedurës për paaftësi paguese dhe njoftimet përkatëse

1. Për qëllime të këtij ligji, çasti i hapjes së procedurës për paaftësi paguese, është çasti në të cilin operatori i sistemit, merr njoftim nga kancelari i gjykatës ose nga Banka e Shqipërisë në cilësinë e autoritetit përgjegjës, për vendimin e hapjes së procedurës së paaftësisë paguese.
2. Kancelari i gjykatës i njofton menjëherë vendimin e hapjes së procedurës së paaftësisë paguese edhe Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
3. Banka e Shqipërisë dhe, sipas rastit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, njoftojnë menjëherë, operatorët e sistemeve të licencuara ose të miratuara prej saj, si dhe pjesëmarrësit e sistemeve që operon vetë, për hapjen e procedurës për paaftësi paguese.
4. Në rast se Banka e Shqipërisë ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare njoftohet nga autoritetet e huaja se ka filluar procedura për paaftësi paguese ndaj pjesëmarrësi ose operatori të huaj, ato informojnë menjëherë operatorët e sistemeve në Shqipëri.
5. Në çdo rast të hapjes së procedurës për paaftësi paguese sipas këtij neni, Banka e Shqipërisë dhe/ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, njofton menjëherë Bordin Evropian të Rrezikut Sistemik (ESRB), shtetet e tjera anëtare dhe Autoritetin Evropian për Titujt dhe Tregjet (ESMA).

Neni 21

Efekti jo prapaveprues i procedurës për paaftësi paguese mbi pjesëmarrjen në sistem

1. Hapja e procedurës për paaftësi paguese ndaj një pjesëmarrësi nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që kanë lindur përpara çastit të hapjes së kësaj procedure dhe që rrjedhin nga, ose lidhen me, pjesëmarrjen e këtij pjesëmarrësi në sistem, sipas rregullave të sistemit dhe këtij ligji.
2. Janë të vlefshme, të ekzekutueshme dhe të detyrueshme ndaj çdo pale të tretë, dhe nuk mund të revokohen, anulohen apo kundërshtohen në çfarëdo mënyre tjetër:
 - a) urdhër-transferta, pagesa e *cash*-it dhe transferata e instrumenteve financiare që rezultojnë nga e tillë urdhër transfertë, në rastet kur ajo ka hyrë në sistem, në përputhje me rregullat e tij, përpara çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese, pavarësisht nëse ajo është shlyer përpara, ose pas çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese; dhe
 - b) netimi i urdhër-transfertave dhe i pretendimeve dhe detyrimeve që rezultojnë nga të tilla urdhër-transferta, në rastet kur ato kanë hyrë në sistem, në përputhje me rregullat e tij, përpara çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese, pavarësisht nëse netimi është kryer përpara, ose pas çastit të hapjes së procedurës për paaftësi paguese.
3. Pika 1 e këtij neni zbatohet dhe në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e një pjesëmarrësi në një sistem të ndërveprueshëm, ose të një operatori të një sistemi të ndërveprueshëm, i cili nuk është pjesëmarrës.
4. Pavarësisht hapjes së procedurës për paaftësi paguese ndaj një pjesëmarrësi në një sistem, operatori ose agjenti shlyerës i një sistemi, nëse i lejohet në bazë të dispozitave kontraktuale të zbatueshme, mund:
 - a) të përdorë *cash*-in dhe instrumentet financiare të disponueshme në llogarinë shlyerëse të pjesëmarrësit për të shlyer urdhër-transfertat e mbetura pezull, si dhe çdo balancë neto debitore që pjesëmarrësi mund t'i detyrohet pas netimit, duke lejuar kështu shlyerjen përfundimtare të urdhër-transfertave të futura në sistem përpara momentit të hapjes së procedurës së paaftësisë paguese dhe të detyrimeve që rrjedhin nga netimi i tyre;
 - b) të ofrojë linjë kredie për pjesëmarrësin dhe të realizojë çdo kolateral të ofruar, me qëllim për të garantojë linjën e kredisë. Realizimi i kolateralit kryhet pa nevojën e miratimit paraprak gjyqësor, pa formalitete shtesë dhe pa penguar karakterin përfundimtar të shlyerjes, në përputhje me rregullat e sistemit.

Neni 22

Efektet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

1. Masat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të marra nga autoriteti përgjegjës, Banka e Shqipërisë, nuk cenojnë vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e urdhër-transfertave,

netimit dhe shlyerjes që janë kryer në përputhje me rregullat e sistemit dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji për finalitetin e shlyerjes.

2. Kjo dispozitë nuk kufizon ushtrimin e kompetencave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ndaj të drejtave, aktiveve ose detyrimeve të tjera, për aq sa ushtrimi i tyre është në përputhje me legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe nuk bie ndesh me mbrojtjen e finalitetit të shlyerjes.

Neni 23

Mbrojtja e të drejtave të kolateralit në sistemet e pagesave dhe operacionet e bankave qendrore

1. Të drejtat e një operatori sistemi ose të një pjesëmarrësi mbi kolateralin e dhënë në lidhje me një sistem ose me një sistem ndërveprues, si dhe të drejtat e Bankës së Shqipërisë dhe, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të bankave qendrore të shteteve anëtare dhe të Bankës Qendrore Evropiane mbi kolateralin e dhënë në kuadër të operacioneve të kryera në cilësinë e tyre si banka qendrore, nuk cenohen nga procedurat e paaftësisë paguese ndaj:
 - a) një pjesëmarrësi në sistemin përkatës ose në sisteme ndërvepruese;
 - b) një operatori të një sistemi ndërveprues që nuk është pjesëmarrës;
 - c) një kundërpale të Bankës së Shqipërisë ose, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të bankave qendrore të shteteve anëtare apo të Bankës Qendrore Evropiane; ose
 - d) çdo pale të tretë që ka dhënë kolateralin.Kolaterali mund të realizohet për përmbushjen e detyrimeve që garantojnë prej tij.
2. Kur një operator sistemi i jep kolateral një operatori tjetër sistemi në lidhje me një sistem ndërveprues, të drejtat e operatorit që ka dhënë kolateralin nuk cenohen nga procedurat e paaftësisë paguese ndaj operatorit marrës.
3. Kur titujt, përfshirë të drejtat mbi titujt, vendosen si kolateral për pjesëmarrësit, operatorët e sistemeve ose Bankën e Shqipërisë, ose pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, bankat qendrore të shteteve anëtare apo Bankën Qendrore Evropiane sipas pikës 1 të këtij neni, dhe e drejta e tyre ose e çdo personi të emëruar, agjenti ose pale të tretë që vepron në emër të tyre, në lidhje me këto tituj, është regjistruar ligjërisht në një regjistër, llogari ose sistem depozitimi të qendëruar të vendosur në një shtet anëtar, përcaktimi i të drejtave të këtyre subjekteve si mbajtës të kolateralit në lidhje me këto tituj do të rregullohet nga ligji i atij shteti.
4. Dispozitat e këtij neni zbatohen pa cenuar kompetencat dhe garancitë e posaçme të parashikuara në legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, për aq sa këto kompetenca ushtrohen në përputhje me mbrojtjen e finalitetit të shlyerjes, netimit dhe kolateralit të dhënë në lidhje me sistemet.

Neni 24
Mbrojtja e llogarisë së shlyerjes

Balanca e *cash*-it dhe e instrumenteve financiare të kredituara në një llogari shlyerje nuk janë objekt i masave të sekuestrimit ose procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm nga asnjë palë e tretë, me përjashtim të rastit kur masa ose procedura përkatëse inicohet nga operatori ose agjenti shlyerës i sistemit.

Neni 25
Njoftimet e sistemeve të njohura (“*designated*”) si sisteme me finalitet shlyerje

1. Operatorët e sistemeve të njohura (“*designated*”) si sisteme me finalitet shlyerje njoftojnë Bankën e Shqipërisë për:
 - a) çdo ndryshim në rregullat e tyre;
 - b) për pjesëmarrësit;
 - c) operatorët mbajnë dhe i vënë në dispozicion Bankës së Shqipërisë një listë të përditësuar të nënpjesëmarrësve të identifikuar sipas rregullave të sistemit. Me kërkesë, Banka e Shqipërisë mund të kërkojë të publikojë listën e nënpjesëmarrësve kur kjo është e nevojshme për qëllime të stabilitetit financiar.
2. Institucionet informojnë Bankën e Shqipërisë, dhe me kërkesë, çdo palë me interes legjitim për sistemet ku merr pjesë dhe rregullat kryesore të tyre.
3. Banka e Shqipërisë dhe/ose Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, njoftojnë pa vonesë Autoritetin Evropian të Titujve dhe Tregjeve (ESMA) për:
 - a) njohjen (“*designation*”) e një sistemi;
 - b) revokimin e njohjes (“*designation*”) të sistemit;
 - c) ndryshimet në rregullat e sistemit;
 - d) fillimin e procedurave të paaftësisë paguese sipas procedurave të përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji.
4. Në zbatim të këtij Kreu, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian bashkëpunojnë me ESMA dhe i japin asaj të gjithë informacionin e nevojshëm pa vonesa.

Neni 26
Ligji i zbatueshëm

1. Në rastin e procedurës për paaftësinë paguese, e filluar kundrejt një pjesëmarrësi të huaj në një sistem që operohet nga Banka e Shqipërisë, ose në një sistem që është i licencuar ose i miratuar prej saj, sipas këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga, ose në lidhje me pjesëmarrjen e atij pjesëmarrësi në sistem, rregullohen nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

2. Në rastin e procedurës për paaftësinë paguese, e filluar kundrejt një pjesëmarrësi shqiptar në një sistem të huaj, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga, ose në lidhje me pjesëmarrjen e atij pjesëmarrësi në sistem, rregullohen nga legjislacioni i vendit që rregullon atë sistem të huaj.

KREU IV SISTEMET E BANKËS SË SHQIPËRISË

Neni 27

Sistemet e Bankës së Shqipërisë

Kreu II i ligjit nuk zbatohet për sistemet në pronësi dhe/ose që operohen nga Banka e Shqipërisë, të cilat nuk licencohen ose miratohen nga asnjë autoritet publik, por duhet të jenë në përputhje me parimet e mbikëqyrjes (“*oversight*”) të miratuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat zbatohen për sisteme të ngjashme të licencuara ose të miratuara.

Neni 28

Rregullat e operimit të sistemeve të Bankës së Shqipërisë

1. Banka e Shqipërisë, me akte nënligjore, miraton rregullat e administrimit dhe operimit të sistemeve të saj, duke përcaktuar kryesisht, por jo vetëm:
 - a) të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve që rrjedhin nga pjesëmarrja e tyre në sistem;
 - b) çasti kur një urdhër-transferte hyn në sistem;
 - c) momentin nga i cili një urdhër-transferte nuk mund të revokohet më nga një pjesëmarrës i sistemit ose nga një palë e tretë;
 - d) rregullat e qarta për mënyrën e shlyerjes së urdhër-transfertës;
 - e) procedurat e shlyerjes që zbatohen në situata normale dhe në situata krize;
 - f) procedurat e administrimit të rrezikut ndaj të cilave ekspozohet sistemi;
 - g) rastet për raportime;
 - h) detyrimet financiare që burojnë nga pjesëmarrja në sistem;
 - i) rregullat që lidhen me operimin e sigurtë, të qëndrueshëm dhe efikas të sistemit.

Neni 29

Masa administrative

1. Banka e Shqipërisë, në rast shkeljeje të nenit 28 të ligjit, si dhe të akteve nënligjore që miraton në lidhje me rregullat e administrimit dhe operimit të sistemeve që operon, merr masa parandaluese, si dhe urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe ndreqjen e pasojave që kanë rrjedhur prej tyre.

2. Banka e Shqipërisë përcakton kushtet e hollësishme dhe metodat për marrjen e masave të përcaktuara në pikën 1.
3. Banka e Shqipërisë me qëllim të garantimit të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të sistemit dhe garantimin maksimal të respektimit të parimeve mbikëqyrëse të sistemeve të pagesave ka të drejtë të vendosë gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) deri në 3 000 000 (tre milionë) Lekë kundrejt, pjesëmarrësve, të sistemeve që operohen prej saj, kur konstaton shkeljet e mëposhtme:
 - a) moszbatim të rregullave të pjesëmarrjes në sistemet e pagesave;
 - b) moszbatim të detyrimeve që burojnë nga pjesëmarrja në sistemet e pagesave;
 - c) vonesa në shlyerjen e pagesave/transfertave, të përsëritura këto mbi numrin kufi të incidencës të përcaktuar në rregullat e sistemit dhe që shkaktohen nga paaftësia e vetë pjesëmarrësi për të shlyer pagesën/transfertën;
 - d) moszbatim të procedurave teknike dhe të sigurisë për operimin në sistemet e pagesave;
 - e) mosraportim ose raportim të pasaktë; mosshlyerjen në afat të detyrimeve financiare, tarifave, komisioneve dhe detyrimeve të tjera që burojnë nga pjesëmarrja në sistemet e pagesave.
4. Kur shkeljet e përcaktuara në pikën 3, përsëriten ose gjoba nuk paguhet brenda afatit dhe, sipas procedurës të përcaktuar në ligjin “Për kundërvajtjet administrative“, Banka e Shqipërisë vendos dyfishimin e gjobës dhe mund të:
 - a) kufizojë përkohësisht pjesëmarrësin ose nënpjesëmarrësin; ose
 - b) pezullojë përkohësisht aksesin në sistem.
5. Gjrobat e vendosura sipas këtij neni, arkëtohen për llogari të Bankës së Shqipërisë. Çdo pjesëmarrës, që cënohet nga një akt administrativ i Bankës së Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë shfuqizimin ose ndryshimin e këtij akti nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë brenda 15 ditëve nga data kur ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose nga data e publikimit të tij.

KREU V MARRËVESHJA E KOLATERALIT FINANCIAR

Neni 30 **Fusha e zbatimit**

1. Dispozitat e këtij Kreu zbatohen për të gjitha marrëveshjet e kolateralit financiar të lidhura ndërmjet personave juridikë, ku të paktën njëra nga palët, marrësi ose dhënësi i kolateralit, bën pjesë në njërën prej kategorive të mëposhtme:
 - a) autoritet publik, vendas dhe i huaj, duke përfshirë organet shtetërore të përfshira në administrimin e borxhit publik dhe organet shtetërore të autorizuar për hapjen dhe administrimin e llogarive të klientëve, me përjashtim të ndërmarrjeve të garantuara

- me fonde publike, përveç rasteve kur këto ndërmarrje bëjnë pjesë në kategoritë e përcaktuara në shkronjat “b” deri në “d”;
- b) Banka e Shqipërisë, një bankë qendrore e huaj, Banka Qendrore Evropiane, Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS), si dhe institucionet financiare ndërkombëtare, përfshirë Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Evropiane të Investimeve, dhe Bankat Shumëpalëshe të Zhvillimit të parashikuara në kuadrin rregullativ për një mbikëqyrje të kujdesshme.
 - c) institucionet financiare subjekte të mbikëqyrjes së kujdesshme, duke përfshirë:
 - i. institucionet e kreditit sipas legjislacionit për institucionet e kreditit;
 - ii. subjektet që ushtrojnë veprimtari financiare të rregulluara sipas legjislacionit për tregjet e kapitalit;
 - iii. shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit sipas legjislacionit për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit;
 - iv. sipërmarrjet e investimeve kolektive dhe shoqëritë administruese të tyre sipas legjislacionit për sipërmarrjet e investimeve kolektive;
 - v. shoqëritë administruese të fondeve të pensionit privat sipas legjislacionit për fondet e pensionit privat.
 - d) kundërpalët qendrore, agjentët e shlyerjes, shtëpitë e klerimit, si dhe çdo subjekt tjetër i licencuar/miratuar dhe i mbikëqyrur që ushtron veprimtari në tregjet e kontratave të së ardhmes, opsioneve ose instrumenteve derivative;
2. Kolaterali financiar, objekt i një marrëveshjeje kolaterali financiar, mund të përbëhet nga *cash*, instrumente financiare ose pretendime kreditore.

Neni 31

Kolaterali financiar i përjashtuar nga fusha e zbatimit

1. Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij Kreu marrëveshjet e kolateralit financiar kur kolaterali financiar përbëhet nga:
 - a) aksionet e vetë dhënësit të kolateralit;
 - b) aksionet në subjekte që janë filiale të dhënësit të kolateralit dhe kontrollohen prej tij sipas legjislacionit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare të konsoliduara;
 - c) aksionet në subjekte, qëllimi i vetëm i të cilave është zotërimi i mjeteve të prodhimit thelbësore për veprimtarinë e dhënësit të kolateralit ose zotërimi i pasurive të paluajtshme;
 - d) pretendime kreditore kur debitori është:
 - i. çdo person fizik që vepron për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare, zanatin ose profesionin e tij; ose
 - ii. një ndërmarrje mikro ose e vogël, sipas kritereve të klasifikimit të ndërmarrjeve referuar madhësisë, të përcaktuara në legjislacionin për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

2. Përfshirja e parashikuar në pikën 1 shkronja “d” nuk zbatohet kur marrësi ose dhënësi i kolateralit është subjekt që bën pjesë në kategoritë e përcaktuara në nenin 30, pika 1, shkronja “b”.

Neni 32

Vlefshmëria dhe njohja e marrëveshjes së kolateralit financiar

1. Krijimi, vlefshmëria, plotësimi, ekzekutueshmëria ose pranueshmëria si provë e marrëveshjes së kolateralit financiar ose dhënia e kolateralit financiar sipas një marrëveshjeje të kolateralit financiar nuk kushtëzohet nga asnjë akt formal, i tillë si regjistrimi, publikimi, noterizimi apo formalitete të tjera administrative ose gjyqësore.
2. Marrëveshja e kolateralit financiar është e vlefshme dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e saj, me kusht që marrëveshja të mund të provohet me shkrim, në formë elektronike, përfshirë regjistrimin me mjet elektronik dhe çdo mjet të qëndrueshëm informacioni, ose në çdo formë tjetër të njohur ligjërisht; dhe
3. Posedimi ose kontrolli mbi kolateralin financiar, që përfshin instrumente financiare dhe *cash*, konsiderohet i realizuar kur këto janë dorëzuar, transferuar, mbajtur, regjistruar ose ndryshe vendosur në mënyrë të tillë që të jenë në posedimin ose nën kontrollin e marrësit të kolateralit ose të një personi që vepron në emër të tij.
4. Posedimi ose kontrolli i kolateralit financiar provohet nëpërmjet identifikimit të tij me shkrim sipas formave të pikës 2 për:
 - a) instrumentet financiare, nëpërmjet kreditimit të tyre në një llogari përkatëse ose evidentimi i tyre si gjendje kreditore në këtë llogari;
 - b) *cash*-i, nëpërmjet kreditimit të tyre në një llogari të përcaktuar ose evidentimi i tyre si gjendje kreditore në këtë llogari;
 - c) pretendimet kreditore, nëpërmjet një listë të pretendimeve, e cila i paraqitet ose i vihet në dispozicion marrësit të kolateralit;
5. Në rastet kur marrëveshja e kolateralit financiar ka për objekt pretendime kreditore, njoftimi i debitorit të pretendimit kreditor kërkohet kur:
 - a) marrësi i kolateralit synon të mbledhë drejtpërdrejt pagesat nga debitori;
 - b) pagesat e pretendimit kreditor duhet të kryhen në favor të marrësit të kolateralit; ose
 - c) ka ndodhur një situatë ekzekutimi dhe marrëveshja e kolateralit financiar parashikon ushtrimin e të drejtave të realizimit mbi pretendimin kreditor.
6. Në rastet kur marrëveshja e kolateralit financiar ka për objekt pretendime kreditore, regjistrimi i saj kërkohet kur:
 - a) kërkohet që të drejtat e marrësit të kolateralit mbi pretendimin kreditor të njihen dhe të zbatohen ndaj palëve të treta;
 - b) kërkohet përcaktimi i përparësisë të marrësit të kolateralit ndaj kreditorëve të tjerë; ose
 - c) i njëjti pretendim kreditor jepet më shumë se një herë si kolateral financiar.

7. Në rast konkurrimi ndërmjet disa të drejtave mbi të njëjtin pretendim kreditor, përparësia përcaktohet sipas momentit të regjistrimit të marrëveshjes së kolateralit financiar.
8. Mungesa e njoftimit ose e regjistrimit sipas pikave 5, 6 dhe 7 të këtij neni nuk çënon vlefshmërinë e marrëveshjes së kolateralit financiar ndërmjet palëve, por kufizon efektet e saj ndaj debitorit të pretendimit kreditor ose ndaj palëve të treta, përfshirë përparësinë ndaj kreditorëve të tjerë.
9. Pa cenuar legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit dhe dispozitat civile për kushtet e pa drejta kontraktore, debitorët e pretendimeve kreditore mund të heqin dorë, me shkrim ose në një formë juridikisht të barasvlershme, nga:
 - a) e drejta për kompensim kundrejt kreditorit të pretendimit kreditor, si dhe kundrejt çdo personi të cilit pretendimi kreditor i është transferuar, dhënë si kolateral ose përdorur si kolateral financiar;
 - b) të drejtat që rrjedhin nga rregullat e sekretit bankar, në masën që këto rregulla pengojnë ose kufizojnë dhënien e informacionit lidhur me pretendimin kreditor ose debitorin, për qëllime të përdorimit të pretendimit kreditor si kolateral financiar.

Neni 33

Ekzekutimi i marrëveshjes së kolateralit financiar

1. Marrësi i kolateralit ka të drejtë që, rast të një situate ekzekutimi, në përputhje me kushtet e përcaktuara në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu, të realizojë kolateralin financiar në mënyrat e mëposhtme:
 - a) në rast se marrëveshja e kolateralit financiar ka për objekt instrumente financiare, ato realizohen nëpërmjet shitjes ose përvetësimit dhe nëpërmjet kompensimit të vlerës së tyre kundrejt detyrimeve financiare përkatëse. ose përdorimit të vlerës ekonomike të tyre për shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse;
 - b) në rast se marrëveshja e kolateralit financiar ka për objekt *cash*-in, ai realizohet nëpërmjet kompensimit të shumës ose përdorimit të tij për shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse;
 - c) në rast se marrëveshja e kolateralit financiar ka për objekt pretendime kreditore, ato realizohen nëpërmjet shitjes ose përvetësimit dhe nëpërmjet kompensimit të vlerës së tyre kundrejt detyrimeve financiare përkatëse, ose përdorimit të vlerës ekonomike të tyre për shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse.
2. Përvetësimi është i mundur vetëm nëse:
 - a) kjo mënyrë është rënë dakord shprehimisht nga palët në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu; dhe
 - b) palët kanë rënë dakord në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu për mënyrën e vlerësimit të instrumenteve financiare dhe pretendimeve kreditore.
3. Mënyrat e realizimit të kolateralit financiar të parashikuara në këtë nen, zbatohen në përputhje me kushtet e marrëveshjes së kolateralit financiar me vendosje pengu, pa asnjë kërkesë që:

- a) të jepet njoftim paraprak për qëllimin për të ekzekutuar;
 - b) kushtet e ekzekutimit të miratohen nga ndonjë gjykatë, zyrtar publik apo çdo person tjetër;
 - c) ekzekutimi të kryhet me ankand publik ose me ndonjë mënyrë tjetër; ose
 - d) të ketë kaluar një periudhë shtesë kohe.
4. Marrëveshja e kolateralit financiar zbatohet sipas kushteve të saj, pavarësisht fillimit ose vazhdimit të procedurave të paaftësisë paguese kundrejt dhënësit të kolateralit ose marrësit të kolateralit.
 5. Realizimi ose vlerësimi i kolateralit financiar, si dhe llogaritja e detyrimeve financiare përkatëse, kryhet në përputhje me marrëveshjen e kolateralit financiar dhe, në çdo rast, në mënyrë të arsyeshme tregtare, duke shmangur veprimet arbitrare ose qartazi të paarsyeshme.
 6. Kur marrësi i kolateralit përvetëson ose kompenson kolateralin financiar, vlerësimi i kolateralit financiar bazohet në vlerën e tregut të instrumenteve financiare ose të pretendimeve kreditore të njëjta apo të ngjashme dhe, në mungesë të një vlere tregu, përcaktohet sipas modeleve financiare të pranura gjerësisht.

Neni 34

E drejta e përdorimit të kolateralit financiar në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu

1. Marrësi i kolateralit ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e përdorimit të kolateralit financiar, kur dhe në masën që kjo parashikohet shprehimisht në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu, dhe vetëm në rastet kur ai përbëhet nga *cash* ose instrumente financiare.
2. Kur marrësi i kolateralit, ushtron të drejtën e përdorimit sipas pikës 1, ai duhet të transferojë kolateral ekuivalent që zëvendëson kolateralin financiar fillestar, jo më vonë se data e përmbushjes së detyrimeve financiare përkatëse të mbuluara nga marrëveshja e kolateralit financiar me vendosje pengu.
3. Në vend të transferimit të kolateralit ekuivalent sipas pikës 2, marrësi i kolateralit në datën e përmbushjes së detyrimeve financiare përkatëse, nëse kjo parashikohet në marrëveshjen e kolateralit financiar me vendosje pengu, mund:
 - a) të kompensojë vlerën e kolateralit ekuivalent kundrejt detyrimeve financiare përkatëse; ose
 - b) të përdorë vlerën ekonomike të kolateralit ekuivalent për shlyerjen e këtyre detyrimeve.
4. Kolateralit ekuivalent, i transferuar në përmbushje të detyrimit sipas pikës 2, është objekt i të njëjtës marrëveshje kolateralit financiar me vendosje pengu si kolateralit financiar fillestar dhe trajtohet si i dhënë sipas të njëjtës marrëveshje dhe në të njëjtën kohë kur kolateralit fillestar u dha për herë të parë.

5. Ushtrimi i së drejtës së përdorimit nga marrësi i kolateralit, sipas këtij neni, nuk cenon vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e të drejtave të tij mbi kolateralin ekuivalent të transferuar sipas pikës 2.
6. Në rast se ndodh një situatë ekzekutimi, ndërkohë që detyrimi për transferimin e kolateralit ekuivalent, sipas pikës 2, mbetet i papërbushur, ky detyrim mund t'i nënshtrohet dispozitës së netimit përfundimtar.

Neni 35

Njohja e marrëveshjes së kolateralit financiar me transferim të titullit të pronësisë

1. Marrëveshja e kolateralit financiar me transferim të titullit të pronësisë është e vlefshme dhe prodhon efekte në përputhje me kushtet e saj.
2. Në rast se ndodh një situatë ekzekutimi, ndërkohë që detyrimi i marrësit të kolateralit për transferim kolateral ekuivalent, sipas marrëveshjes së kolateralit financiar me transferim të titullit të pronësisë, mbetet i papërbushur, ky detyrim mund t'i nënshtrohet dispozitës së netimit përfundimtar.

Neni 36

Kolaterali financiar zëvendësues dhe kolaterali financiar shtesë

1. Marrëveshja e kolateralit financiar mund të parashikojë:
 - a) detyrimin për të dhënë kolateral financiar për të reflektuar shumën e detyrimeve financiare përkatëse ose kolateral financiar shtesë për të reflektuar ndryshimet në vlerën e kolateralit financiar; ose
 - b) të drejtën për të tërhequr kolateral financiar, me kusht që të jepet, nëpërmjet zëvendësimit ose shkëmbimit, kolateral financiar me vlerë thelbësisht të njëjtë.
2. Dhënia e kolateralit financiar, e kolateralit financiar shtesë ose e kolateralit financiar zëvendësues sipas këtij neni nuk përbën një marrëveshjeje të re kolateralit financiar ndërmjet palëve.
3. E drejta e dhënësit të kolateralit për të zëvendësuar kolateralin financiar me kolateral tjetër ekuivalent, e drejta për të tërhequr kolateralin financiar të tepërt në favor të dhënësit të kolateralit ose, në rastin e pretendimeve kreditore, e drejta për të mbledhur pagesat që rrjedhin prej tyre deri në një njoftim tjetër, nuk çenojnë faktin që kolaterali financiar konsiderohet i dhënë në favor të marrësit të kolateralit në përputhje me këtë ligj.

Neni 37

Vlefshmëria dhe njohja e dispozitës së netimit përfundimtar

1. Dispozita e netimit përfundimtar prodhon efekt dhe është e zbatueshme në përputhje me kushtet e përcaktuara, pavarësisht:
 - a) hapjes ose vazhdimin të procedurave të paafësisë paguese kundrejt dhënësit të kolateralit dhe/ose marrësit të kolateralit; dhe/ose

- b) çdo mase sigurimi, çdo forme sekuestroje, apo çdo urdhri, vendimi ose mase tjetër të ngjashme gjyqësore, përmbarimore apo çdo akti të një organi apo nëpunësi tjetër, në lidhje me të drejtat për kolateralin që është subjekt i kësaj dispozite.
2. Zbatimi i dispozitës së netimit përfundimtar kryhet pa qenë e nevojshme përmbushja e kërkesave të nenit 33, pika 3, përveç rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe.

Neni 38

Efekti joprapaveprues mbi kolateralin financiar në rastet e paaftësisë paguese

1. Marrëveshja e kolateralit financiar, si dhe dhënia e kolateralit financiar në kuadër të një marrëveshjeje të tillë, nuk mund të deklarohet e pavlefshme, ose nul ose të revokohet vetëm mbi bazën se ka një marrëveshje kolaterali financiar ose se kolaterali financiar është dhënë:
 - a) në ditën e fillimit të procedurave të paaftësisë paguese, por përpara nxjerrjes së vendimit ose aktit që urdhëron fillimin e tyre; ose
 - b) brenda një periudhe të caktuar përpara fillimit të procedurave të paaftësisë paguese, duke iu referuar fillimit të tyre ose duke iu referuar nxjerrjes së ndonjë vendimi, akti ose ndodhjes së ndonjë veprimi apo ngjarjeje tjetër në kuadër të këtyre procedurave.
2. Marrëveshja e kolateralit financiar ose dhënia e kolateralit është e vlefshme, ligjërish e zbatueshme dhe prodhon efekte ndaj palëve të treta me kusht që detyrimi financiar përkatës të ketë lindur, ose kolaterali financiar të jetë dhënë, në ditën e fillimit, por pas momentit të fillimit të procedurave të paaftësisë paguese, me kusht që marrësi i kolateralit të mund të provojë se nuk ishte në dijeni dhe as nuk duhej të ishte në dijeni për fillimin e këtyre procedurave.
3. Ky nen zbatohet edhe në rastet e dhënies së kolateralit financiar shtesë, të kolateralit financiar zëvendësues dhe të kolateralit financiar të shkëmbyer sipas nenit 36 duke përfshirë edhe rastet kur detyrimet financiare përkatëse kanë lindur përpara datës së ofrimit të kolateralit financiar, të kolateralit financiar shtesë ose të kolateralit zëvendësues.
4. Pa cenuar parashikimet e pikave të tjera të këtij neni, rregullat e përgjithshme që lidhen me mashtrimin, abuzimin ose simulimin sipas legjislacionit civil, të legjislacionit për falimentimin, si dhe atij penal, zbatohen në lidhje me anulimin ose kundërshtimin e transaksioneve të kryera gjatë periudhës së përcaktuar në pikën 1, shkronja “b”, si dhe për transaksionet e pikës 3 për periudhën e përcaktuar në pikën 1, shkronjat “a” dhe “b”.

Neni 39

Radha e preferencës së të drejtave mbi pengun

1. Të drejtat e marrësit të kolateralit mbi kolateralin financiar të lënë peng, të përbërë nga *cash* ose instrumente financiare, kanë përparësi ndaj të drejtave të çdo kreditori tjetër të dhënësit së kolateralit.

2. Për kolateralin financiar të përbërë nga pretendime kreditore, përparësia ndaj palëve të treta dhe kreditorëve të tjerë përcaktohet në përputhje me rregullat e regjistrimit të parashikuara në këtë ligj.

Neni 40

Marrëdhënia me legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme

Ushtrimi i të drejtave që rrjedhin nga marrëveshjet e kolateralit financiar, përfshirë realizimin e kolateralit financiar, të drejtën e përdorimit dhe dispozitën e netimit përfundimtar, i nënshtrohet kufizimeve ose pezullimeve të përkohshme të parashikuara në legjislacionin për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme, pa cenuar vlefshmërinë, efektivitetin ose zbatueshmërinë e marrëveshjeve të kolateralit financiar.

Neni 41

Ligji i zbatueshëm për titujt e dematerializuar

1. Të drejtat mbi titujt e dematerializuar evidentohen në llogarinë përkatëse që mbahet nga ose në emër të një ndërmjetësi.
2. Për titujt të dematerializuar zbatohet ligji i shtetit në të cilin mbahet llogaria përkatëse, i cili rregullon edhe çështjet e mëposhtme:
 - a) natyrën ligjore dhe efektet e pronësisë të titujve të dematerializuar;
 - b) kërkesat për lidhjen e marrëveshjes së kolateralit financiar që ka objekt këto tituj, dhënien e tyre si kolateral bazuar në këtë marrëveshje, dhe në përgjithësi përmbushjen e hapave të nevojshëm për ta bërë efektive marrëveshjen dhe dhënien e tyre ndaj palëve të treta;
 - c) përparësinë ndërmjet personave që pretendojnë të drejta mbi këto titujt të dematerializuar të dhënë si kolateral financiar, ose mbrojtjen e personave që fitojnë të drejta mbi to nëpërmjet blerjes në mirëbesim;
 - d) hapat e nevojshëm që kërkohen për realizimin e titujve të dematerializuar të dhënë si kolateral financiar, në rast se ndodh një situatë ekzekutimi.

KREU VI

PROVAT

Neni 42

Pranueshmëria e provës elektronike dhe optike

Ekzistenca, përmbajtja, afati i çdo urdhër-transferte, hyrja e tij në një sistem, si dhe ekzekutimi i tij mund të vërtetohen në të gjitha çështjet, qofshin ato civile, penale ose administrative, kundrejt pjesëmarrësit ose ndonjë pale të tretë, me shkrim ose me mjete të qëndrueshme, që sigurojnë gjurmimin e tij, qoftë në formë optike ose elektronike, duke përfshirë kopje të printuara të dokumenteve të tilla elektronike ose optike.

Neni 43
Procedura “truncation”

Banka e Shqipërisë, nëpërmjet akteve nënligjore, mund të organizojë procedurën “truncation” të instrumenteve të pagesave, duke përcaktuar edhe pasojat e kësaj procedure për pjesëmarrësit dhe sistemet e përfshira në procesimin e këtyre instrumenteve.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 44
Shfuqizime

Ligji nr. 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”, i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 45
Zbatimi i akteve nënligjore ekzistuese

1. Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave” konsiderohen si të miratuara në bazë të këtij ligji.
2. Në rast mospërputhje të dispozitave të akteve nënligjore, me dispozitat e këtij ligji, do të zbatohet ky ligj.

Neni 46
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të rregullimeve që lidhen me kolateralin financiar të përbërë nga pretendime kreditore të cilat hyjnë në fuqi pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, si dhe çdo dispozitë ku citohet shprehimisht hyrja në fuqi pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI